



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni...

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 03./2010
Më 25.01.2010, në orën 13.30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Nerxhivane Dauti, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Sala Berisha - Shala, Zef Morina, Qamile Morina dhe Myfera Sinik.

Kurse mungoi: Slobodan Petroviq.

Pjesëmarrës të tjerë: Hakif Jashari - U.D. - sekretar - MEM - it, Besim Veselaj, U.D. - MEM, Ramadan Klisurica - KDI, Sagita Muco - ICO, Lejla Selimi - OSBE dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi : Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

R e n d i i d i t ë s :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19. 01. 2010;
3. Shqyrtimi i Strategjisë së energjisë për periudhën 2009-2018 , vazhdim;
4. Shqyrtimi i Raportit të punës për vitin 2009;
5. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për anëtarët e Komisionit për miniera dhe minerale;
6. Te ndryshme;

1.Miratimi i rendit të ditës

Ethem Çeku - Nuk ishte i pajtimit me pikën 3 (tre) të rendit të ditës, gjegjësisht për vazhdimin e shqyrtimit të Strategjisë së energjisë për periudhën 2009-2018. Ai tha se deri sa nuk kemi informata shtesë dhe nuk është prezente ministresha e MEM-it, vazhdimi i shqyrtimit të strategjisë do jetë përsëritje qëndrimesh dhe konstatimesh.

Sala Berisha – Shala - Ishte e mendimit se “Strategjia “ duhet të mbetet në rend dite dhe të nxirret rekomandimi për Kuvend.

Edhe anëtarët e tjerë ishin të mendimit se shqyrtimi i Strategjisë duhet të vazhdojë edhe pse nuk është prezente ministresha e MEM-it (ishte prezent përfaqësuesi Hakif Jashari, u.d. sekretar)

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e renditjes së pikave 4 dhe 5.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19. 01. 2010;

Miratimi i procesverbalit u shty për mbledhjen e radhës nga se nuk ishte shpërndarë.

3. Shqyrtimi i Strategjisë së energjisë për periudhën 2009-2018,- vazhdim nga mbledhja e kaluar.

Ethem Çeku - Si në mbledhjen e kaluar e kontestoi përfshirjen e termocentralit “Kosova B” në pakon tenderuese të termocentralit “Kosova e Re”, si dhe zvoglimin e kapaciteteve gjeneruese të termocentralit “Kosova e Re” nga 2000 MW në “500+500 MW.

Ai vazhdoi duke theksuar se lidhur me Projektin për termocentralin “Kosova e Re” vërejtjet i kam thënë edhe më parë dhe vazhdoj t’i them edhe më tutje. Në radhë të parë tha se mungon një program për zhvillimin ekonomik, në bazë të të cilit do duhej pastaj edhe të pasonte edhe Projekti dhe kapacitetet gjeneruese të termocentralit “Kosova e Re”. Strategjia për energji 2009 - 2018, sipas Ligjit rishqyrtohet dhe plotësohet për çdo tri vjet. Kjo është e mirëseardhur për kushtet tona, por për disa çështje bazike bëhet vonë. Ai në vazhdim vlerësoi se vendosja e termocentralit “Kosova B” në pakon tenderuese të “Kosova e Re”, pa analiza paraprake dhe pa ndonjë arsytim të qëndrueshëm është lëshim dhe pa përgjegjësi. Ndërtim i kapaciteteve energjetike do duhej planifikuar për përmbushjen e nevojave që do ketë vendi sot dhe në të ardhmen duke përfshirë edhe eksportin. Ai vlerësoi se vendi ka lëndë të mjaftueshme për prodhimin e energjisë, për të cilin konstatim janë bërë analiza të shumta, si dhe Projekti për prodhim kapaciteti prej 2000 MW. Kosova sipas disa analizave ka shtim kërkesash për energji prej 7% për çdo vit. Nëse tani nuk i ndërtojmë kapacitetet tona gjeneruese në pajtim me Planin që nuk ekziston ose vizionin për zhvillim ekonomik, në një të ardhme të afërt do detyrohemi që prapë të importojmë energji si edhe tani. Sikur Komiteti drejtues, dhe MEM- i të kishin mbajtur dëgjime publike dhe bërë analiza të qëndrueshme dhe të besueshme dhe të na ishin prezantuar dhe arsyetuar neve në Komision, ne do ta kishim pasur shumë më lehtë të përcaktohem për qëndrueshmerinë e strategjisë. Në fund ai u deklarua se nuk pajtohet me këtë strategji dhe si të tillë nuk do ta përkrahë.

Fatmir Rexhepi - Sipas tij kanë mbetur dy çështje themelore të hapura, për të cilat ne do duhej të deklarohejmë, e që sipas tij janë me shumë rëndësi: çështja e përfshirjes së termocentralit “Kosova B” në pakon e tenderimit të privatizimit dhe kapaciteti gjenerues “Kosova e Re”. Ai tha se për të pasur një qendrim të qartë lidhur me çështjet kontestuese do duhej të kishim analiza shtesë mbështetëse. Sipas tij këto dy çështje nuk duhet miratuar si të tilla, deri sa të mos kemi fakte bindëse se janë zgjidhja më e mirë e mundshme për rrethanat ekzistuese. Meqenëse nuk i kemi argumentet bindëse, ne duhet që këto paqartësi dhe dilema t’i përcjellim dhe parashtrijmë përmes Komisionit dhe formave të tjera edhe në seancën e Kuvendit.

Qamile Morina - Ishte e mendimit se për këtë çështje me shumë rëndësi do duhej të organizohet një dëgjim publik, pastaj të debatohet edhe në grupe parlamentare dhe të gjitha vlerësimet paraprake të barten në seancë, ku edhe do finalizohet i tërë projekti.

Kaqusha Jashari - E vlerësoi si të nevojshme sjelljen e informatës – konkluzioneve nga MEM-i që kanë dalë nga Konferenca e investitorëve, që ishte mbajtur ditë më parë në Prishtinë. Ajo vlerësoi se këto konkluzione të kësaj konference do të kishin shërbyer për përcaktim dhe rekomandime për Kuvendin e Kosovës.

Zef Morina – Tha se në pakon e Projektit tenderues “Kosova e re” të mos jetë “Kosova B”, ndërsa për kapacitet gjeneruese të fillohet 500+ 500 MW. Kështu që në projekte duhet të precizohet saktë se cilat kapacitete do t’i jepen investitorit të ri. Komisioni duhet të nxjerrë rekomandim me vërejtjet tona dhe të njëjtat të përcillen edhe në Kuvend. Në qëndrimet tona individuale i bartim edhe në grupet parlamentare, ku pastaj në seancën e Kuvendit edhe do hamonizohen dhe miratohen.

Fatmir Rexhepi - Përsëri këmbënguli se tenderimi i “Kosova B” nuk duhet lejuar pa analiza të bollshme, ndërsa sa i përket kapacitetit gjenerues të termocentralit “Kosova e Re”, që të fillojë me minimumin gjenerues prej 1000 MW, nga se ekzistojnë resurset natyrore, mundësia e shfrytëzimit dhe zhvillimit ekonomik që do ta ketë Kosova. Ai tha se sido që të jetë rekomandimi unë qëndrimin tim do ta përcjellë edhe në grupin parlamentar dhe në seancë të Kuvendit.

Myzjene Selmani - Në bazë të asaj që u tha mund të konkludojmë se Komisioni duhet të parashtrijë dilemat përmes Rekomandimit dhe “Strategjia e energjisë 2009-2018” të debatohet në të njëjtën frymë edhe në Kuvend.

Në fund Komisioni u pajtua që të nxirret rekomandimi si vijon:

Kuvendi i Republikës së Kosovës e mbështet në parim Strategjinë e energjisë për periudhën 2009-2018 duke kërkuar që:

- a) Termocentrali “Kosova B” të mos përfshihet në pakon tenderuese të privatizimit (të mbetet në pronësi të shtetit).
- b) Termocentrali “Kosova e Re” të ndërtohet në lokacionin “Kosova A” dhe
- c) për kapacitetin gjenerues të termocentralit “Kosova e Re” të bëhet studim i gjithanshëm (fizibiliteti).

Arsyetim:

a) Përfshirja e termocentralit “Kosova B” në pakon tenderuese të privatizimit, është e paqëndrueshme dhe nuk i ka paraprirë kurrfarë analize ose debati të mirëfilltë. Termocentrali “Kosova B” duhet të mbetet pasuri nacionale e që do ishte në favor të politikës sociale me vetë faktin se shteti do ishte edhe konkures dhe ndikues në politiken e tregut të lirë.

b) Termocentrali “Kosova e Re” do të duhej të ndërtohet në lokacionin “Kosova A”, sepse do të ishte shumë më ekonomik në aspektin hapësinor, të ruajtjes së ambienti dhe të kosotos së ndërtimit.

c) Për kapacitetin gjenerues (500 MW + 500 MW) të “Kosova e Re” vlerësohet nuk ka studim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm. Shoqërinë kosovare, ekonomike e industriale duhet parë me një perspektivë të gjithanshme zhvillimore. Projekti i termocentralit “Kosova e Re” do të duhej të ishte në rolin paraprijës të zhvillimit të përgjithshëm të Kosovës, por edhe të përcjellës dhe përmbushës së kërkesave të gjithmbarshme të shoqërisë, ekonomisë dhe industrisë kosovare në raport me kërkesat dhe kohen.

4. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për anëtarët e Komisionit për miniera dhe minerale:

Myjje Selmani - I njoftoi anëtarët se nga kryetari i Kuvendit kërkohet në mënyrë urgjente të shqyrtohet Vendimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të KPMM- së, i cili material u është shpërndarë me kohë.

Ethem Çeku - U deklarua se nuk pajtohet me propozimin e Qeverisë për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të PMM - së. Ai propozoi që t'iu zgjatet afati ish - anëtarëve të Bordit për gjashtë muaj, si ishte propozuar nga kryesia ditë më parë. Këtë propozim e mbështeti në faktin se Projektligji për miniera dhe minerale është në përfundim të shqyrtimit dhe pasi të miratohet në seancën e Kuvendit Bordi i KPMM- së do zgjidhej në pajtim me procedurat që i përcakton Ligji i ri për MM-në.

Fatmir Rexhepi- U pajtua që të shqyrtohet lista e propozuar nga Qeveria dhe të procedohet në Kuvend me të njëjtit emëra. Ai vlerësoi se kandidatët e propozuar në aspektin formal i plotësojnë kushtet.

Sale Berisha – Shala - Vlerësoi se kandidatët e propozuar nga Qeveria i plotësojnë kushtet sipas Ligjit në fuqi për miniera dhe minerale. Andaj propozoi që të njëjtit të procedohen për në seancën e Kuvendit.

Në bazë të diskutimit dhe pajtimit edhe të anëtarëve të tjerë, kryetarja propozoi që të votohen kandidatët e propozuar për anëtarë të KPMM- së nga Qeveria dhe të procedohen për në Kuvend.

Në bazë të shumicës së anëtarëve Komisioni nxori këtë :

Rekomandim

Kuvendi i Republikës së Kosovës e mbështet Propozim vendimin e Qeverisë së Republikës të Kosovës nr. 02/104 të 16. 01. 2010 për emërim të anëtarëve të Komisionit për miniera dhe minerale, si vijon:

- 1.Ahmet Tmava
- 2.Xhevdet Kastrati
- 3.Ibush Jonuzi dhe
- 4.Shaip Latifi

5. Shqyrtimi i Raportit të punës për vitin 2009;

Raporti i punës për vitin 2009 u miratue pa vrejttje.

6.Te ndryshme

Fatmir Rexhepi propozoi që për mbledhjen e radhës të ftohet ministri i Ministrisë për TT- në dhe të raportojë për situatën aktuale lidhur me Projektin e autoudhës “Morinë - Merdar”. Pas diskutimit Komisioni nxori këtë

Përfundim

- I. Mbledhja e radhës mbahet më 02. 02. 2010, në të cilën do të shqyrtohet: Situata aktuale lidhur me Projektin e autoudhes “Morinë-Merdar”

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani